

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve S. Sh. nga Juniku , për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par .1 të KPRK-ës , veprës penale lëndim i lehtë trupor në vazhdimësi nga neni 188par.1 dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje asgjësim apo dëmtimit të pasurisë nga neni 333 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.183/16 të datës 13.06.2016, në shqyrtimin gjyqësor, të mbajtur më datë **15.03.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj ,te dëmtuarit I. K. ,te akuzuarve A. D. ,V. K. , L. S. dhe F. Sh. , me dt.19.03.2018 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. D.** , nga Deçani ,Rr”... “,nr.1, i biri i F. dhe i S. e gjinisë K. , data e lindjes ... ne Deçan ,ka te kryer shkollën e mesme , i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar atë i 3 fëmijëve ,shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **V. K.** , nga fsh.Ll. K Deçani , i biri i M. dhe i S. e gjinisë B., data e lindjes ... ne Deçan ,ka te kryer shkollën e mesme , i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar atë i 2 fëmijëve ,shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **L. S.** , nga fsh. Ll. K Deçani , i biri i Rr. dhe i C. e gjinisë K , data e lindjes ...ne Deçan ,ka te kryer shkollën e mesme , i pa punë, i gjendjes se dobët ekonomike, i martuar atë i 3 fëmijëve ,shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **F. SH.** ,nga Juniku , data e lindjes ..., me banim ne Junik, lagjja “...” ,i biri i Skënderit dhe i nënës Z. e gjinisë K. ,ka te kryer shkollën e mesme ,punëtor ,i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i pa martuar ,me nr.ID

I.PJESA NDËSHKUESE

Të akuzuarit A. D. dhe V. K.

J a n ë f a j t o r:

Sepse:

I –

-me dt.10.02.2016, në Rr.” ” në Gjakovë, në lokalin “ ...”, i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshme te shëndetit ,në atë mënyrë qe pas një fjalosje dhe mosmarrëveshje te çastit qe ka ndodhur mes te pandehurve A. dhe V. K. dhe te pandehurit S. ne anën tjetër ,aty fillon një rrahje mes tyre dhe me grushte dhe shqelma e sulmojnë ne kokë dhe fytyrë te dëmtuarin – te pandehurin S. Sh. ,me çka i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshëm te shëndetit ,gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U.,dt.18.04.2016.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-31 te KPRK-ës .

I akuzuari F. Sh.

Sepse:

II.

-me dt. 10.02.2016, rreth orës 00.30, tek rreth rrotullimit afër stacionit e autobusëve ne Gjakovë, pasi e ndjekin automjetin e tipit “...” qe gjendeshin te pandehurit A. D., V. K. dhe L. S., ua zënë rrugën me automjetin e tipit “...” dhe me mjete te forta e godasin automjetin e te pandehurve ashtu qe me një shkop druri thyejnë xhamin e pare i pandehuri F. Sh., ndërsa xhamin e pasmë me bishte te sopat e godet i pandehuri S. Sh. duke i shkaktuar kështu dëme materiale ne automjet.

-me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1-31 te KPRK-ës.

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,41,43,46,73,74, nenit 188 par.1-31 dhe nenit 333/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, te akuzuarve iu shqipton;

DËNIM ME GJOBË

I.

Të akuzuarit A. D., me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 30 ditëve duke llogaritur prej dt.10.02.2016 deri me dt.10.03.2016, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) euro.

Të akuzuarit V. K., me dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 30 ditëve duke llogaritur prej dt.10.02.2016 deri me dt.10.03.2016, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) euro.

II.

Të akuzuarit F. Sh., për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1 të KPRK-ës të paraparë në pikën II të aktakuzës, dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- € (njëzetë) euro**.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit qe në mënyrë solidare te paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër te ekspertizave ligjore shume prej **70.00 euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej nga **20.00.-€**, ne afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij Aktgjykimi.

Gjykata ne kuptim te dispozitës 62 par .2 pika 2.7 te KPRK-ës, të akuzuarit F. Sh., ia shqipton masën :

MARRJA E SENDEVE

Konfiskohet sopata dhe një shkop druri qe janë është objekte të veprës penale e të sekuestruara me dt. 10.02.2016

II.PJESA REFUZUESE

Për të akuzuarin L. S. :

Ne baze te nenit 363/1 pika 1.1 te KPPK-së , për te akuzuarin L. S. dhe F. Sh. :

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse:

I. me dt.10.02.2016, Rr.” ” , në Gjakovë, në lokalit “....”, i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshme te shëndetit ,në atë mënyrë qe pas një fjalosje dhe mosmarrëveshje te çastit qe ka ndodhur mes te pandehurve A. dhe V. K. dhe te pandehurit S. ne anën tjetër ,aty fillon një rrahje mes tyre dhe me grushte dhe shqelma e sulmojnë ne kokë dhe fytyre te dëmtuarin –te pandehurin S. Sh. ,me çka i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshëm te shëndetit ,gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore e Dr. N. U.,dt.18.04.2016

-me çka në bashkëkryerje do te kishte kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-31 te KPRK-ës

Për te akuzuarin F. Sh. :

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse:

II. me datë ,kohë, vend dhe mënyrë e përshkruar si ne dispozitivin e II-të aktgjykimit , i pandehuri F.gjersa me shkop te drurit thyen xhamin e parë te automjetit aty i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarit V. K. ,lëndime këto nga copëzat e xhamit qe i bien ne fytyrë me rastin e goditjes se bere nga i pandehuri .

-me çka do te kishte kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/2-1 te KPRK-ës

Për arsye se prokurori shtetit gjate shqyrtimit gjyqësor ka hekë dore nga aktakuza për te akuzuarin L. S. nga dispozitivi i I-rë të aktakuzës dhe për te akuzuarin F. Sh. nga dispozitivi i VI-të i aktakuzës .

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës .

Ar s y e t i m

Prokuroria Themelore-në Gjakovë ,ka ngritë aktakuzën PP.nr.183/16 të dt. 13.06.2016,te përmirësuar gjate shqyrtimit fillestar te dt. 21.03.2017, kundër të akuzuarve S. Sh. nga Juniku për shkak te veprave penale lëndim i rende trupor nga neni 189/1 ,lëndim i lehtë trupor në vazhdimësi nga neni 188/1-81 dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1-31 te KPRK-ës ,te akuzuarin A. D. nga Deçani ,V. K. nga fsh. Ll.K Deçan dhe L. S. nga Deçani, për shkak se kanë kryer veprën

penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/1-31 te KPRK-ës ,te akuzuarin F. Sh. për shkak te veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/2-1 dhe veprës penales asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1-31 te KPRK-ës .

Në shqyrtimin gjyqësor te dt. 15.03.2018, Gjykata jashtë shqyrtimit ka marr aktvendim P.nr. 339/16 ,me te cilën hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Gjakovë ,PP.nr. 183/16 te dt. 13.06.2016,dhe ka pushuar procedura penale ndaj te akuzuarit S. Sh. nga Juniku , për shkak te veprave penale lëndim i rende trupor nga neni 189/1 ,lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1-81 dhe veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1-31 te KPRK-ës ,për shkak te *vdekjes* se te akuzuarit, gjë qe u vërtetua sipas certifikatës e vdekjes me nr. ref. 19/2018RV/19001 te dt.12.03.2018 .

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe publikë te mbajtur me të datë 15.03.2018, Prokurori i shtetit Dëshrie Jusaj ka deklaruar se ne këtë fazë te procedurës me qe këtu i akuzuari –i dëmtuari L. S. gjatë këtij rasti sipas shkresave te lendes qe nga fillimi i mosmarrëveshjeve ka pësuar lëndime te renda trupore për çka ne asnjë fazë e gjere me sot nuk ka arritur te provohet se me veprimet e te njëjtit i janë shkaktuar lëndime siç janë përshkruar me rastin e ngritjes se aktakuzës , duke marr parasysh faktin se vërtet i njëjtit natën kritike kishte marr lëndime vërtet te renda trupore për çka edhe na kanë bërë te qartë te kuptojmë se si ka mund ky ne atë gjendje ti shkaktoje tjetrit lëndime trupore , andaj edhe mbështetur ne deklarimet e te dy te akuzuarve paraprak si A. D. dhe V. K. , ne këtë fazë tërhiqem nga ndjekja penale si prokurore e çështjes sa i përket te akuzuarit – te dëmtuarit L. S. . Në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës PP.nr.183 /16 te dt.13.06.2016, sa i përket te akuzuarve A. D. dhe V. K. lidhur me dispozitivin e I-rë te aktakuzës , po ashtu mbetem ne tërësi pranë aktakuzës sa i përket diapozitivit te V-të për të akuzuarin F. Sh. ,për veprën penale te përshkruar ne dispozitiv te kësaj pike , po ashtu gjendja faktike e përshkruar ne këto dy pika te aktakuzës me këta tre te akuzuar si me lartë u vërtetua me vet faktin e pranimit te fajësisë se këtu te akuzuarve gjë qe vërtetuan edhe bazueshmerin ligjore te përshkrimit te veprave te tyre te kryera ne këta dy dispozitave. E po ashtu deklarimi i te akuzuarve i bere i vullnetshëm ,pa presion ,te vetëdijshme për pasojat e pranimit te fajësisë .Përgjegjësie penale e këtu te akuzuarve vërtetohet edhe me ekspertizat e ekspertëve mjeko –ligjor ne lende ,përgjegjësia e këtu te akuzuarve është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitares I. L. dhe provat tjera përcjellëse ne shkresat e lendes . E përsërisë se ne këtë seancë gjyqësorë kemi hequr dore nga ndjekja penale për te akuzuarin tanimë te ndjerë S. Sh. , vërtetësinë e vdekjes se tij e vërtetuan edhe me certifikatën e vdekjes te prezantuar ne ketë seancë nga i biri F. Sh.. Andaj bazuar ne te lartcekurat konsiderojë se këtu te akuzuarit e lartpërmendur duhen te përgjigjën penalisht dhe te obligohen ne pagesën e shpenzimet e procedurës

I dëmtuari I. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim demi .

I dëmtuari - L. S. , në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashka ngjitem ndjekjes penale dhe kompensimin e demit do ta realizojë ne marrëveshje me te akuzuarin F. Sh. dhe atë sipas marrëveshjes qe do te arrihet mes veti.

I akuzuari A. D. , gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 15.03.2018 deklaroi se: ne këtë fazë te procedurës me qene se i akuzuari S. Sh. ka vdekur ,shprehi keqardhje familjarit te tij me rastin e vdekjes dhe deklaroi se e pranojë fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohem dhe atë duke i ditur pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë. I propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,faktin se kam qene ne paraburgim ne kohëzgjatje prej 30 ditësh, gjendjen time te varfër ekonomike si dhe faktin se asnjëherë me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë ne këtë fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritët ,andaj i propozoi gjykatës

qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,kërkim falja nga te familjaret e te dëmtuarit,i propozoi gjykatës te me shqiptojë një dënim sa me te butë

I akuzuari V. K. , gjate shqyrtimit gjyqësor lidhur me fajësinë deklaroi se ne këtë fazë te procedurës me qene se i akuzuari S. Sh. ka vdekur ,shprehi keqardhje familjarit te tij me rastin e vdekjes dhe deklaroi se e pranojë fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohem dhe atë duke i ditur pasojat dhe favoret e pranimit te fajësisë. I propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,faktin se kam qene ne paraburgim ne kohëzgjatje prej 30 ditësh, gjendjen time te varfër ekonomike si dhe faktin se asnjëherë me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë ne kete fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritët ,andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,kërkim falja nga te familjaret e te dëmtuarit ,i propozoi gjykatës te me shqiptojë një dënim sa me te butë .

I akuzuari F. Sh., gjate shqyrtimit gjyqësor lidhur me fajësinë deklaroi se ne këtë fazë te procedurës deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohem te kryer ne bashkëkryerje për veprën penale te asgjësimit apo dëmtimit te pasurisë nga neni 333/1 te KPRK-ës ,me prindin S. Sh. i cili ka vdekur, mirëpo nuk e pranon fajësinë për veprën penale te parapare ne piken e VI-të te aktakuzës ku pandehem për veprën penale te lëndimit te lehtë trupor te shkaktuar te akuzuarit V. K. me qene se unë te njëjtit nuk i kam shkaktuar lëndime për çka edhe mund te deklaroi vete i akuzuari –i dëmtuari . Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë ne këtë fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritët, kërkojë falje nga këtu i dëmtuari për demin e shkaktuar për çka edhe do te shpreh gatishmërinë qe sipas mundësive te ia kompensojë demin ,andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike faktin se me pare nuk ka qene i dënuar te me shqiptojë një dënim sa me te butë .

I akuzuari –i dëmtuari V. K. gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se gjatë veprimeve te ndërmarra nga i ndjeri S. Sh. gjersa ndodheshim ne automjet kur e kanë goditur automjetin me mjete te forta me janë shkaktuar lëndimet qe do te thotë lëndimet nuk me janë shkaktuar nga i akuzuar F. Sh. por nga S. Sh. .

Prokurori i shtetit Dëshire Jusaj , deklarojë se sa i përket dispozitivit te VI-të te aktakuzës qe ka të beje me te akuzuarin F. Sh. i pandehur edhe për veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/2-1 te KPRK-ës , tërhiqem nga ndjekja penale për këtë vepër penale dhe këtë duke u bazuar edhe ne deklaratën e vete te dëmtuarit V. K. e te cilën e dha ne mënyra vullnetare pa presion duke kërkuar qe te sqarojë gjendjen faktike te ditës kritike për çka edhe mua si prokurore e çështjes i njëjti me këtë rast arrit te me shpije në heqje dore nga ndjekja penale sa i përket pikës se VI-të te aktakuzës ku te dëmtuar kishim V. K. .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që iu vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave të mëtejme .

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si

rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh ,pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarit, sjelljen korrekte të akuzuar ve në gjykim , pendimin e tyre të shprehur për veprën e kryer, ,kërkim falje nga familja e te dëmtuarit –te akuzuarit, gjendjen e tyre varfër ekonomike, ndërsa për të akuzuarin F. Sh. si rrethanë lehtësuese mori për bazë edhe gatishmërinë e pagesës së dëmit të dëmtuarit borgjit , të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 74 të KPRK-së, Gjkata të akuzuarve A. D. dhe V. K. te akuzuar për veprën penale lëndim i lehte trupor te kryer ne bashkëkryerje nga neni 188/1-31 te KPRK-ës ,iu shqiptoj dënim me gjobë në shume prej nga 600(gjashtëqind) euro , në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 30 ditëve duke llogaritur prej dt.10.02.2016 deri me dt.10.03.2016 , ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të llogaritet nga 20 (njëzet)euro, ndërsa te akuzuarit F. Sh. i akuzuar për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333/1 te KPRK-ës dënim me gjobë ne shume prej 200(dyqind) euro si , me bindje se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara ne kontest civil për realizimin e kërkesë pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mur konform nenit 450/2 pika 2.1 dhe 2.6 te KPPK-ës .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,

P. nr. 339/ 16 më datë 19.03.2018.

**Sekretarja juridike
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.